

RREGULLORE PËR PUNË

Instrumenti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor

Komiteti për monitorim MK-EU

Komiteti për Monitorimin e Instrumentit për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor (në tekstin e mëtejshëm “Komiteti për Monitorimin e IRR-së për BP-në”) është trup i themeluar në pajtim me nenin 25 të Marrëveshjes për Instrumentin, të lidhur në mes Komisionit Evropian dhe Maqedonisë së Veriut për aranzhime specifike për implementimin e ndihmës financiare nga Bashkimi Evropian për Maqedoninë e Veriut në kuadër të Instrumentit për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor, në tekstin e mëtejshëm “IRR-ë për BP-në”.

Neni 1

Fushëveprimi dhe detyrat

- (1) Komiteti për Monitorimin e IRR-së për BP-në vlerëson shkallën dhe cilësinë e realizimit të të gjitha reformave dhe investimeve në drejtim të përmbushjes së objektivave të përcaktuara në Agjendën reformuese dhe në Rregulloren e (BE-së) 2024/1449. Për këtë qëllim, shfrytëzuesi duhet të vendosë monitorim të rregullt dhe sistematik, si në nivel politik ashtu edhe në nivel teknik, si dhe aranzhmane për njoftim për të informuar për progresin drejt arritjes së rezultateve të planifikuara, ku do të sigurohet se raportimi deri te Komisioni është i saktë dhe gjithëpërfshirës.
- (2) Komiteti për Monitorimin e IRR-së për BP-në diskuton për progresin e realizimit lidhur me kërkesat dyvjeçare të dorëzuara për lirimin e mjeteve financiare të parashtruara nga partnerët relevant. Komiteti për Monitorimin e IRR-së për BP-në mund të jep propozime deri te Komisioni dhe Koordinatorin e IRR-së për përmirësimin e efektivitetit të përgjithshëm, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e reformave dhe investimeve, pasi që të gjithë ne sigurojmë koherencë dhe koordinim më të mirë me ndihmën në kuadër të IPA III dhe

ndihmën financiare nga donatorë të tjerë. Për këtë qëllim, ku është gjegjëse, i merr parasysh konkluzionet dhe rekomandimet e marra nga monitorimi dhe vlerësimet e filluara nga Komisioni ose nga shfrytëzuesi i IRR-së.

(3) Komiteti për monitorimin e IRR-së për BP-në për fushën përkatëse të politikës ose fushën e reformave:

- (a) e shqyrton progresin drejt përmbushjes së qëllimeve, arritjen e reformave dhe hapave të planifikuara, si dhe vlerësimin e ndikimit dhe qëndrueshmërisë së Agjendës reformuese, duke siguruar njëkohësisht koherencë me dialogun për politika, strategjitë qendrore dhe rajonale përkatëse sektoriale, shtyllat 1 dhe 2 të Planit për rritje dhe implementimin e IPA III;
- (b) i prezanton dhe diskuton raportet vjetore;
- (c) i shqyrton konstatimet dhe konkludimet relevante, si dhe propozimet për masa korrigjuese të cilat rrjedhin nga monitorimi, vlerësimet dhe revizionet, nëse janë të qasëshme, dhe e shqyrton planin e veprimit të përgatitur pas kontrollit të sistemeve;
- (ç) diskuton të gjitha aspektet përkatëse të funksionimit të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit;
- (d) i diskuton të gjitha çështjet dhe veprimet problematike;
- (dh) nëse është e nevojshme, ndërmerr çdo veprim për të siguruar arritjen e qëllimeve dhe përmirësimin e efektivitetit, ndikimit dhe qëndrueshmërisë së reformave dhe investimeve në kuadër të Agjendës reformuese;
- (e) i shqyrton masat e ndërmarra për informim, publicitet, transparencë, komunikim dhe dukshmëri, në pajtim me nenet 21 dhe 23.

Neni 2

Përbërja dhe Kryesia

- (1) Komiteti për Monitorimin e IRR-së për BP-në përbëhet nga përfaqësues të Komisionit, të Qeverisë shfrytëzues, duke përfshirë edhe Koordinatorin e Instrumentit për reforma dhe rritje (në tekstin e mëtejshëm “koordinatori i IRR-së”), dhe të trupave të tjerë relevant, siç janë donatorët dypalësh, organizatat ndërkombëtare, institucionet financiare ndërkombëtare, organizatat të shoqatave qytetare (civile), organizatat të sektorit privat dhe shtetet anëtare të BE-së.
- (2) Përfaqësuesi i Komisionit Evropian dhe koordinatori i IRR-së bashkëkryesojnë me takimet e Komitetit për Monitorimin e IRR-së për BP-në.

Neni 3

Sekretariati i Komitetit për monitorimin e IRR-së për BP-në

- (1) Komiteti i Monitorimit i IRR-së për BP-në mbështetet nga „Sekretariati“ i përhershëm. Sekretariati organizohet nga koordinatori i IRR-së me mbështetje nga Delegacioni i BE-së
- (2) Sekretariati i kryen të gjitha detyrat e nevojshme për zbatimin e drejtë të punës së Komitetit për monitorimin të IRR-së për BP-në, dhe veçanërisht
 - a) mbledh dhe/ose përpunon dhe shpërndan dokumentet dhe materialet (raportet, analizat, propozimet, prezantimet etj.) të të gjithë anëtarët e Komitetit për Monitorimin e IRR-së për BP-në të nevojshme për punën e Komitetit;
 - b) organizon dhe implementon përgatitjen e takimeve të Komitetit dhe ndihmon në aktivitetet e tij;
 - c) përgatit konkludimet operative nga takimet e Komitetit për Monitorimin e IRR-së për BP-në dhe i konsolidon raportet;
 - (ç) është përgjegjës për ruajtjen e dokumentacionit të Komitetit për Monitorimin e IRR-së për BP-në;
 - (d) siguron publicitet, siç është gjegjëse, lidhur me punën e Komitetit për

Monitorimin e IRR-së për BP-në;

(dh) kryen detyra të tjera lidhur me punën e Komitetit për Monitorimin e IRR-së për BP-në të caktuara nga koordinatori i IRR-së.

(3) Sekretariati është pika e kontaktit për Komitetin për Monitorimin e IRR-së për BP-në dhe e gjithë korespondenca lidhur me aktivitetet e Komitetit i adresohet atij.

Neni 4

Takimet e Komitetit për monitorimin e IRR-së për BP-në

- (1) Komiteti për Monitorimin e IRR-së për BP-në mblidhet të paktën një herë në vit pas dorëzimit të raportit vjetor. Në pajtim me nenin 25(1) të Marrëveshjes për instrumentin, Komiteti i parë për monitorim mblidhet më së voni 6 muaj nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes. Takime ad hoc mund të thirren gjithashtu me iniciativë të Komisionit Evropian ose të koordinatorit të IRR-së.
- (2) Sekretariati i dërgon ftesat në formë të shkruar së bashku me draft- rendin e ditës, pesëmbëdhjetë ditë para datës së mbledhjes së Komitetit për Monitorimin e IRR-së për BP-në. Dokumentet plotësuese duhet të dorëzohen të paktën dhjetë ditë para mbledhjes. Informacionet dhe të gjitha dokumentet dhe materialet e nevojshme mund të dorëzohen edhe përmes e-mail-it.
- (3) Anëtarët e Komitetit për Monitorimin e IRR-së për BP-në mund të dorëzojnë propozime për ndryshime të rendit të ditës në formë të shkruar, drejtuar Sekretariatit, më së voni, dhjetë ditë para mbledhjes. Të gjitha ndryshimet e rendit të ditës pas këtij afati mund të bëhen vetëm me konsensus në mes anëtarëve të Komitetit.
- (4) Komiteti për Monitorimin e IRR-së për BP-në e aprovon rendin e ditës në fillim të çdo mbledhjeje.
- (5) Gjuha e punës e Komitetit për Monitorimin e IRR-së për BP-në është gjuha angleze. Shfrytëzuesi siguron përkthim simultan nga dhe ndaj gjuhës zyrtare nacionale dhe përkthim të dokumenteve kur është e nevojshme.

Neni 5

Pjesëmarrja në mbledhjet e Komitetit për Monitorimin e IRR-së për BP-në

- (1) Anëtarët e Komitetit për Monitorimin e IRR-së për BP-në, të shënuar në Aneksin 1, marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit në mënyrë të përhershme.
- (2) Në rast se një anëtar nuk mund të marrë pjesë në mbledhje të Komitetit, ai/ajo mund të zëvendësohet nga zëvendësi i tij/saj.
- (3) Koordinator i IRR-së e informon Komisionin dhe të gjithë anëtarët e Komitetit për përbërjen e Komitetit. Të gjitha propozimet për ndryshime në pjesëmarrjen në Komitet duhet të dorëzohen deri te Sekretariati të paktën dhjetë ditë para mbledhjes së tij.
- (4) Nëqoftëse është përkatëse, siç është shënuar në Aneksin 2, pjesëmarrës plotësues nga organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë institucionet financiare ndërkombëtare dhe palët e tjera të interesuara, siç janë vendet anëtare të BE-së, organizatat e shoqërisë civile (qytetare) dhe sektori privat, ftohen të marrin pjesë në mbledhjet ad hoc.
- (5) Sekretariati zgjedh organizatat e shoqërisë civile (qytetare) me qëllim që të sigurohet përzierjeje homogjene të ekspertizës sektoriale. Më pas, Sekretariati nga Këshilli qeveritar kërkon bashkëpunim me Organizatat e Shoqatave Civile (qytetare) të nominojë përfaqësues nga organizatat qytetare (civile) sipas sektorëve. Propozimi do të dërgohet deri te Sekretariati të paktën një muaj para mbledhjes përkatëse. Në këtë drejtim, nëqoftëse konsiderohet për përkatëse Delegacioni i BE-së ose koordinatori i IRR-së mund të propozojnë përfaqësues plotësues të shoqërisë civile (qytetare).
- (6) Lista e personave të ftuar, e shënuar në Aneksin 1 dhe Aneksin 2, dakordohet me Komisionin.

Neni 6

Procesverbale nga mbledhjet

- (1) Sekretariati harton draft-konkludime operative dhe rekomandime, si dhe procesverbale nga secili takim i Komitetit për monitorimin e IRR-së për BP-në.
- (2) Draft-konkludimet operative dorëzohen deri te anëtarët e Komitetit për Monitorimin e IRR-së për BP-në për komente ose korrigjime në afat prej dhjetë ditëve pas mbledhjes. Draft-versioni i procesverbalit, i cili përmban rendin e ditës të takimit dhe listën e pjesëmarrësve, u dorëzohet pjesëmarrësve në afat prej njëzet ditëve pas mbledhjes.

Procesverbali i mbledhjes paraprake miratohet zyrtarisht në mbledhjen e radhës të Komitetit për monitorimin e IRR-së për BP-në.

- (3) Konkludimet operative nga takimi publikohen në ueb faqen e Instrumentit për reforma dhe rritje.
- (4) Konkludimet operative janë lëndë e monitorimit dhe shqyrtimit përkatës në mbledhjet e ardhshme të komitetit.

Neni 7

Kodi i sjelljes

- (1) Anëtarët dhe pjesëmarrësit e Komitetit për monitorimin e IRR-së për BP-në marrin pjesë në vendosjen, ruajtjen dhe zbatimin e standardeve të larta të sjelljes së Komitetit të monitorimit të IRR-së për BP-në dhe personalisht i respektojnë këto standarde, me qëllim të ruajtjes së integritetit të Komitetit.
- (2) Anëtarët dhe pjesëmarrësit e Komitetit për monitorimin e IRR-së për BP-në nuk e shfrytëzojnë anëtarësimin dhe pjesëmarrjen e tyre në Komitet për të përfituar çfarëdo lloj dobie ose privilegji për veten ose për të tjerët.

Neni 8

Dispozitat përfundimtare

- (1) Rregullorja aktuale e punës së Komitetit duhet të miratohet nga anëtarët e tij në mbledhjen e parë.
- (2) Rregullorja e punës mund të ndryshohet nga Komiteti me propozime me shkrim nga cilido prej anëtarëve, të shoqëruara me diskutime dhe me pëlqimin e Koordinatorit të IRR-së dhe Komisionit.

Aneksi 1: Anëtarët e Komitetit për monitorim

1. Koordinator i IRR-së;
2. Përfaqësues të Komisionit Evropian;
3. Përfaqësues të Delegacionit të BE-së në Maqedoninë e Veriut;
4. Përfaqësues të Ministrisë së Financave, Ministrisë për Çështje Evropiane dhe/ose institucioneve të tjera të përfshira në menaxhimin dhe kontrollin e IRR-së;;
5. NIPAK dhe/ose zyra e tij;
6. Njësia NJKLKM
7. Njësia qendrore për harmonizim;
8. Institucioni i Lartë për revizion (Enti Shtetëror për Revizion);
10. Përfaqësues të trupave të tjerë relevant në pajtim me nenin 2(1).

Aneksi 2: Pjesëmarrës në Komitetin për monitorim

Përfaqësues plotësues të palëve të përfshira vijuese mund të ftohen ad hoc për të marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit për Monitorimin e IRR-së për BP-në, duke mos u kufizuar vetëm në:

1. Ministritë relevante, agjencitë dhe shfrytëzuesit përfundimtarë;
2. Organizatat e shoqërisë civile (qytetare), operatorët ekonomikë dhe partnerët socialë;
3. Akademitë dhe universitetet;
4. Organizatat ndërkombëtare dhe institucionet financiare;
5. Përfaqësues të shteteve anëtare;
6. Çdo trup ose person tjetër i cili mund të konsiderohet përkatës.